

REPUBLIKA E KOSOVËS
ODA E INXHINIERËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS
KOMISIONI I ANKESAVE

Nr. prot. 02/2025

Data: 02.05.2025

Prishtinë

VENDIM

Në mbështetje të nenit 25 të Udhëzimit Administrativ MFPT-NR. 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, nenit 19 të Ligjit Nr. 08/L-012 për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit, nenit 26 të Statutit të Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës për periudhën e përkohshme, si dhe nenit 10 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, Komisioni i Ankesave i OIRK-së, në mbledhjen e mbajtur më datë 25.04.2025, në përbërje: Kryetar: Petrit Hajrizi , Anëtarë: Bekim Ahmeti dhe Ekrem Sallahaj pas shqyrtimit të ankesës së paraqitur nga z. Agron Kuqi, nxjerr këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e paraqitur nga z. Agron Kuqi, e datës 08.04.2025. Në fuqi mbetet Raporti i Përzgjedhjes së Kandidatëve për pozitën Drejtor Ekzekutiv i OIRK-së, i hartuar nga Komisioni Vlerësues më datë 01.04.2025.

ARSYETIM

Komisioni i Ankesave shqyrtoi ankesën e z. Agron Kuqi, e cila pretendon shkelje të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të disa akteve ligjore dhe nënligjore, përfshirë: Ligjin e Punës Nr. 03/L-212; Ligjin Nr. 06/L-144 për Zyrarët Publikë; Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative; Ligjin Nr. 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi; Udhëzimin Administrativ MFPT-NR. 01/2024

Pas shqyrtimit të pretendimeve dhe dokumentacionit përkatës, Komisioni i Ankesave konstaton se:

Oda e Inxhinierëve dhe organet e saj funksionojnë mbi bazën e Ligjit Nr. 08/L-012 dhe Statutit të saj, dhe nuk janë subjekt i zbatimit të Ligjit për Zyrtarët Publikë dhe Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Marrëdhëniet e punës rregullohen nga Ligji i Punës Nr. 03/L-212 dhe aktet përkatëse të brendshme të OIRK-së.

Procedura e rekrutimit për pozitën Drejtor Ekzekutiv është zhvilluar në përputhje të plotë me UA MFPT-NR. 01/2024 dhe aktet e brendshme të OIRK-së.

Z. Agron Kuqi me date 08.04.2025 ka ushtruar ankese zyrtare në adresë të Komisionit të Ankesave. Ai ka qenë pjesë e procesit të vlerësimit në mënyrë të barabartë me kandidatët e tjerë ku është ftuar për intervistë më 21.03.2025.

Intervista dhe vlerësimi janë realizuar nga një komision me pesë anëtarë, duke përdorur formularë të standardizuar të vlerësimit, të miratuar paraprakisht nga Bordi Drejtues.

Sipas rezultateve përfundimtare të intervistës së datës 01.04.2025, z. Kuqi është renditur në vendin e tretë me 52.22 pikë.

Procedura ka qenë e hapur, transparente dhe është zhvilluar në përputhje me të gjitha dispozitat ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Komisioni i Ankesave nuk ka gjetur shkelje në pretendimin e ankuesit se nuk janë zbatuar të gjitha dispozitat e ligjit të punës që nga hapja e konkursit. Nuk janë gjetur shkelje lidhur me parregullesitë gjatë procedurave të rekrutimit.

Komisioni nuk ka konstatuar elemente të Shkeljes së dinjeitetit dhe nderit të individit, parimeve të barazisë, transparencës, diskriminimit, përdorimit të pyetjeve të papërshtatshme dhe komenteve përbuzëse gjatë intervistës apo shkelje gjatë procesit të rekrutimit.

Në mungesë të provave që dëshmojnë shkelje të rënda procedurale apo ligjore, Komisioni vlerëson se ankesa është e pabazuar në fakte apo në ligj.

KËSHILLË JURIDIKE

Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë të paraqesë padi pranë gjykatës kompetente brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Për Komisionin e Ankesave të OIRK-së
Prishtinë, më 02.05.2025



Petrit Hajrizi
Kryetar i Komisionit të Ankesave



Bekim Ahmeti
Anëtar i Komisionit të Ankesave



Ekrem Sallahaj
Anëtar i Komisionit të Ankesave